

## K O N V E N T Ë

### MIDIS REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË DHE REPUBLIKËS POPULLORE TË HUNGARISË PËR DHËNIEN E NDIHMËS JURIDIKE NË QËSHTJET CIVILE FAMILJARE DHE PENALE

Presidiumi i Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Presidiumi i Republikës Popullore të Hungarisë të udhëhequr nga dëshira për të forcuar miqësinë e ngushtë dhe të qëndrueshme midis të dy vendeve edhe në fushën e marrëdhënieve juridike, vendosën të përfundojnë Konventën mbi dhënieën e ndihmës juridike për çështjet civile, familjare dhe penale.

Për këtë qëllim ata emëruan si të plotfuqishëm të tyre:

Presidiumi i Kuvendit Popullor i Republikës Popullore të Shqipërisë, Bilbil Klosi, Ministër i Drejtësisë i Republikës Popullore të Shqipërisë.

Presidiumi i Republikës Popullore të Hungarisë, Dr. Ferenc Nezval, Ministër i Drejtësisë i Republikës Popullore të Hungarisë

të cilët, pas shkëmbimit të plotfuqishmërive të tyre, që u gjetën në regull të plotë dhe në formën e duhur, u muarën vesh për sa vijon:

MPJ ARKIVI

VITI: 1960

DOSJA:

FLETA: 44/

PJESA E I-rë  
DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 1

Mbrojtja juridike

1. Shtetasit (personat fizikë dhe juridikë) të njerës Palë Kontraktonjëse gëzojnë në teritorin e Palës tjetër Kontraktonjëse po atë mbrojtje juridike të personit dhe të pasurisë si edhe shtetasit e kësaj Palë Kontraktonjëse.

2. Shtetasit e njerës Palë Kontraktonjëse mund të paraqiten në organet e Palës tjetër Kontraktonjëse në kompetencën e të cilëve janë çështjet civile, familjare dhe penale, të ngrejné padi, të paraqisin kërkesa dhe ankesa po në ato kushte si dhe shtetasit e Palës tjetër Kontraktonjëse.

Neni 2.

Dhënia e ndihmës juridike

1. Gjykatat, organet e prokurorisë dhe të noterisë shtetërore të Palëve Kontraktonjëse u japin njeri tjetrit ndihmë juridike në çështjet civile, familjare dhe penale.

2. Organet që përmenden në pikën 1, u japin ndihmë juridike edhe organeve të tjera, në kompetencën e të cilëve hyjnë çështjet civile, familjare dhe penale.

Neni 3.

Mënyra e komunikimit

Në dhënien e ndihmës juridike organet e përmendura në nenin 2 komunikojné midis tyre nëpërmjet organeve të tyre qendrore për gjersa nuk parashikohet ndryshe nga kjo Konventë.

Neni 4

Vëllimi i ndihmës juridike

Ndihma juridike jepet me anë të kryerjes së veprimeve të veçanta proceduriale, në veçanësi me anë të kryerjes së kontrollimeve, të kqyrjeve dhe të sekuestrimit të pasurisë, të dërgimit dhe të dorëzimit

MPJ ARKIVI

VITI: 1960

DOSJA:

FLETA: 64

të provave materiale, të pyetjes së të pandehurve, dëshmitarëve dhe ekspertëve, të pyetjes së palëve dhe personave të tjerë, të kqyrjes gjyqësore, me anën e plotsimit të porosisë për dorëzimin e dokumentave, të dërgimit të materialeve të çështjeve, të përpilimit dhe dërgimit të dokumentave.

#### Neni 5

#### Forma e porosisë për dhënie ndihmë juridike

1. Porosia për dhënie ndihmë juridike duhet të përmbajë këto të dhëna:

- a) Emërtimin e organit që bën porosinë;
- b) Emërtimin e organit të cilit i drejtohet porosia;
- c) Emërtimin e çështjes për të cilën kërkohet dhënia e ndihmës juridike;
- ç) Emrin dhe mbiemrin e palëve, të të akuzuarve, të të pandehurve ose të dënuarve, vendbanimin ose vendqëndrimin e tyre të përherëshëm, shtetësinë, profesionin, dhe për çështjet penale mundësisht edhe vendin dhe datën e lindjes së të akuzuarve dhe emrat e prindërve të tyre;
- d) emrat, mbiemrat dhe adresat e përfaqësuesve të tyre;
- dh) përmbajtjen e porosisë dhe njoftimet të nevojshëm për kryerjen e porosisë dhe, për çështjet penale, edhe përshkrimin e figurës të krimit.

2. Materialet që dërgohen në bazë të kësaj Konvente duhet të kenë vulën dhe nënshkrimin.

3. Për kërkesat për dhënien e ndihmës juridike Palët Kontraktuese përdorin formulare në dy gjuhë tekstin e të cilëve ato ia njoftojnë njera tjetrës.

#### Neni 6

#### Mënyra e kryerjes së porosisë

1. Në kryerjen e porosisë për dhënien e ndihmës juridike organi, të cilit i është drejtuar porosia, zbaton legjislacionin e shtetit të tij. Por, me kërkesën e organit që bën porosinë, ai mund të zbatojë

MPJ ARKIVI

VITI: 1960

DSJA:

FLETA: 24

normat proceduriale të Palës Kontraktgjëse që bën porosinë, në qoftë se ato nuk vijnë në kundërshtim me legjislacionin e shtetit të tij.

2. Kur organi, të cilit i drejtohet porosia, nuk është kompetent për kryerjen e saj, atëherë ai ia dërgon porosinë organit kompetent dhe njofton për këtë organin që ka bërë kërkesën.

3. Me kërkesën e organit, i cili ka bërë porosinë, organi të cilit i është drejtuar porosia njofton me kohë ate për kohën dhe vendin e kryerjes së porosisë.

4. Pas kryerjes së porosisë, organi, të cilit i është drejtuar kërkesa, ia kthen dokumentat organit që ka bërë porosinë ose i njofton atij për pengesat në kryerjen e porosisë.

#### Neni 7

##### Paprekshmëria e dëshmitarëve dhe ekspertëve

1. Dëshmitari ose eksperti që paraqitet në organet e Palës Kontraktgjëse, e cila ka bërë porosinë, me ftesë të dorëzuar atij nga Organi i Palës Kontraktgjëse, që i është drejtuar porosia, pavarësisht nga shtetësia e tij, nuk mund t'i nënshtrohet ndjekjes ose arrestimit, qoftë për vepra të dënuarshme penalisht, që përbëjnë objektin në shqyrtim, qoftë për ndonjë vepër tjetër, që dënohet penalisht, të kryer para se të kalonte kufirin e shtetit që ka bërë porosinë, as mund të dënohet gjithashtu për vepra të tilla në teritorin e Palës Kontraktgjëse që ka bërë porosinë.

2. Dëshmitari ose eksperti e humbet këtë garanci në qoftë se ai nuk e le teritorin e Palës Kontraktgjëse që ka bërë porosinë brënda një jave nga dita kur organi që ka bërë porosinë e njofton ate se qëndrimi i mëtejshëm i tij s'është i nevojshëm. Në këtë afat nuk llogaritet koha gjatë së cilës dëshmitari ose eksperti, pa fajin e tij, nuk ka mundur të lërë teritorin e Palës Kontraktgjëse që ka bërë porosinë.

#### Neni 8

##### Porosia për dorëzimin e dokumentave

1. Organi, të cilit i drejtohet porosia, dorëzon dokumentat në përputhje me legjislacionin për dorëzimin e dokumentave që është në

MPJ ARKIVI

VITI: 1960

POSJA:

FLETA: 647

fuqi në shtetin e tij, në qoftë se dokumentat që dorëzohen janë të përpiluara në gjuhën e Palës Kontraktgjëse së cilës i drejtohet porosia, ose atyre u është bashkëgjatur përkthimi i vërtetuar. Në raste të tjera, organi, që i drejtohet porosia, ia dorëzon këtë dokument të adresuarit kur ky i fundit e pranon atë vullnetarisht.

2. Në porosinë për dorëzimin e dokumentave duhet të shënohen adresa e përpiktë e marrësit dhe emërtimi i dokumentave, që duhet të dorëzohen.

3. Kur dokumenti nuk mund të dorëzohet në adresën që tregohet në porosinë, organi, të cilit i drejtohet porosia, me inisjativën e tij, duhet të marrë masat e nevojshme për të gjetur adresën. Kur gjetja e adresës nga organi, të cilit i është drejtuar porosia, është e pamundur ai njofton për këtë organin që ka bërë porosinë dhe i kthen këtë dokument që duhej të dorëzoheshin.

#### Neni 9

##### Vërtetimi i dorëzimit të dokumentave

Vërtetimi i dorëzimit të dokumentave bëhet në përputhje me dispozitat mbi dorëzimin e dokumentave që janë në fuqi në shtetin të cilit i drejtohet porosia. Në vërtetimin e dorëzimit duhet të shënohen data dhe vendi i dorëzimit.

#### Neni 10

##### Dorëzimi i dokumentave shtetasve të vet

1. Palët Kontraktgjëse kanë të drejtë t'u dorëzojnë dokumentat shtetasve të tyre nëpërmjet përfaqësive të tyre diplomatike ose konsullore.

2. Në një dorëzim të tillë nuk mund të përdoren masa detyronjëse.

#### Neni 11

##### Shpenzimet lidhur me dhënien e ndihmës juridike

1. Për dhënien e ndihmës juridike, Palë Kontraktgjëse, së cilës i është drejtuar porosia, nuk mund të kërkojë pagimin e shpenzimeve. Palët Kontraktgjëse marrin përsipër të gjitha shpenzimet lidhur me dhënien e ndihmës juridike në teritoret e tyre.

2. Organi, të cilit i është drejtuar porosia, i njofton orga-

MPJ ARKIVI

VITI: 1960

NR.:

FLETA: 24

nit që ka bërë porosinë, shumën e shpenzimeve. Në qoftë se organi që ka bërë porosinë do të marrë këto shpenzime nga personi që detyrohet t'i paguaj ato, këto i mbeten Palës Kontraktgjyqësore që i ka kërkuar.

Neni 12

Njoftime

Ministritë e Drejtësisë së Palëve Kontraktgjyqësore me kërkesë i japin njera tjetrës njoftime mbi aktet legjislative që janë në fuqi ose që kanë qënë në fuqi në shtetet e tyre si edhe njoftime mbi interpretimin e akteve legjislative nga organet gjyqësore përkatëse të Palëve Kontraktgjyqësore.

Neni 13

Përdorimi i gjuhëve në dhënien e ndihmës  
juridike

Organet e Palëve Kontraktgjyqësore në komunikimet midis tyre në lidhje me dhënien e ndihmës juridike përdorin gjuhët e tyre ose gjuhën ruse.

Neni 14

Vërtetimi dhe njohja e dokumentave

1. Dokumentat e përpiluara, të përgatitura ose të vërtetuara nga organet e njerës Palë Kontraktgjyqësore brenda kompetencave të tyre dhe që janë pajisur me vulë me stemë pranohen në teritorin e Palës tjetër Kontraktgjyqësore pa ndonjë vërtetim tjetër.

2. Dokumentat zyrtare, të cilat janë përgatitur nga organi kompetent i njerës Palë Kontraktgjyqësore, kanë fuqinë provuese të dokumentave zyrtare edhe në teritorin e Palës tjetër Kontraktgjyqësore.

PJESA E II-të

PJESË E POSAÇME

KAPITULLI I-rë

NDIHMJA JURIDIKE PËR QËSHTJET CIVILE DHE FAMILJARE  
Çkarkimi nga sigurimi i shpenzimeve gjyqësore dhe nxjerja e tyre

Neni 15

1. Shtetasve të njerës nga Palët Kontraktgjyqësore që marrin pjesë në çështjet gjyqësore në gjykatat e Palës tjetër Kontraktgjyqësore dhe

MPJ ARKIVI

VITI: 1960

DOSJA:

FLETA: 69

që banojnë në teritorin e njerës nga Palët Kontraktgjësore nuk mund t'u ngarkohet detyrimi për sigurimin e shpenzimeve gjyqësore vetëm për shkak se janë të huaj ose nuk kanë në këtë vend vendbanimin ose vend qëndrimin e përherëshëm.

2. Shtetasit e njerës Palë Kontraktgjësore gëzojnë lehtësinë që përmendet në pikën 1 edhe në atë rast, kur ata banojnë në teritorin e një shteti me të cilin Pala Kontraktgjësore që u jep këtë lehtësi, ka një Konventë që siguron në mënyrë reciproke nxjerrjen e shpenzimeve gjyqësore.

#### Neni 16

1. Në qoftë se shtetasit të çkarkuar nga sigurimi i shpenzimeve gjyqësore në bazë të nenit të më sipërm ngarkohen me pagimin e shpenzimeve gjyqësore, gjykata përkatëse e Palës tjetër Kontraktgjësore lejon, në bazë të kërkesës pa taksa, ekzekutimin e nxjerrjes së detyrueshme të këtyre shpenzimeve.

2. Në shpenzimet gjyqësore përfshihen edhe shpenzimet për përkthimin dhe vërtetimin e dokumentave që përmenden në nenin 17 të kësaj Konvente.

#### Neni 17

1. Kërkesës për ekzekutimin e nxjerrjes së detyrueshme të shpenzimeve gjyqësore duhet t'i bashkëgjyket kopja e vërtetuar e vendimit të gjykatës mbi shpenzimet, si dhe vërtetimi i lëshuar nga gjykata, që ka dhënë vendimin, se vendimi ka marrë formë të prerë dhe duhet të ekzekutohet.

2. Dokumentat e përmendura duhet të pajisen me përkthimin e bërë në gjuhën e Palës Kontraktgjësore në teritorin e së cilës kryhet ekzekutimi i nxjerrjes së detyrueshme të shpenzimeve.

3. Gjykata që lejon ekzekutimin e vendimit, për nxjerrjen e detyrueshme të shpenzimeve gjyqësore, shikon vetëm:

a) në se vendimi ka marrë formë të prerë dhe në se duhet të ekzekutohet;

b) në se dokumentat e përmendura në pikën 1 janë të paisura me një përkthim të vërtetuar.

#### Neni 18

Kërkesa për nxjerrjen e shpenzimeve në teritorin e Pa-

RPJ ARKIVI

VITI: 1960

NUMERI:

FLETA: 24

lës tjetër Kontraktonjëse mund tu paraqiten:

a) gjykatës që mori vendimin mbi shpenzimet, ose gjykatës që ka shqyrtuar çështjen në shkallë të parë. Kjo gjykatë ia përcjell kërkesën gjykatës kompetente të Palës tjetër Kontraktonjëse;

b) drejt për drejt gjykatës së Palës tjetër Kontraktonjëse, e cila është kompetente të marrë vendim për nxjerrjen e shpenzimeve gjyqësore.

#### Neni 19

1) Gjykata shqyrton kërkesën për nxjerrjen e shpenzimeve gjyqësore pa marrë në pyetje palët.

2. Gjykata që është kompetente për të marrë vendim mbi nxjerrjen e shpenzimeve, zgjidh çështjen për nxjerrjen e shpenzimeve që përmenden në pikën 2 të nenit 16 të kësaj Konvente. Këto shpenzime përcaktohen nga gjykata kompetente të Palës Kontraktonjëse në teritorin e së cilës ato lindën.

3. Pranimi i kërkesës për nxjerrjen e shpenzimeve nuk mund të refuzohet për shkak se kërkuesi nuk ka parapaguar shpenzimet që duhet të nxjerrë.

#### Çkarkimi nga shpenzimet gjyqësore

#### Neni 20

Shtetasit e njerës Palë Kontraktonjëse në teritorin e Palës tjetër Kontraktonjëse çkarkohen nga shpenzimet dhe taksat gjyqësore dhe gëzojnë lehtësira të tjera në taksat dhe lehtësira në lidhje me ndihmën juridike, po në ato kushte dhe po në atë vëllim si dhe shtetasit e saj. Këto lehtësira shtrihen në të gjitha veprimet procedimore duke përfshirë edhe veprimet e ekzekutimit të detyrueshëm.

#### Neni 21

1. Dokumentat mbi gjendjen personale, familjare, pagën dhe pasurinë lëshohen nga organet kompetente të Palës Kontraktonjëse në teritorin e së cilës personi, që paraqiti kërkesën, ka vendbanimin ose vendqëndrimin e përherëshëm.

2. Kur personi që paraqiti kërkesën nuk ka vendbanimin ose vendqëndrimin as në teritorin e njerës Palë Kontraktonjëse, as në terito-

NPJ ARKIVI

1960

USJA:

ELETA: 24



rin e Palës tjetër Kontraktonjëse, dokumenti lëshohet nga përfaqësia diplomatike ose konsullore e shtetit të tij.

3. Gjykata që vendos mbi çkarkimin nga shpenzimet gjyqësore mund të kërkojë në rast nevojë shpjegime plotësuese nga organi që ka lëshuar dokumentin sipas mënyrës së parashikuar në nenin 3 të kësaj Konvente

#### Neni 22

1. Shtetasi i njerës Palë Kontraktonjëse që dëshëron të paraqesë gjykatës së Palës tjetër Kontraktonjëse kërkesën për çkarkimin nga shpenzimet gjyqësore dhe taksat (ose të përfitojë nga ndihma juridike falas ose nga lehtësira të tjera lidhur me taksat), mund tja paraqesi këtë kërkesë me gojë gjykatës kompetente në vendbanimin ose vendqëndrimin e tij të përherëshëm, e cila mben proces verbalin e rastit. Kjo gjykatë, proces verbalin bashkë me dokumentin që përmendet në nenin 21, si edhe dokumentat e tjera të paraqitura nga personi i interesuar, ia përciell gjykatës përkatëse të Palës tjetër Kontraktonjëse.

2. Proces verbali duhet të përpilohet në gjuhën e gjykatës që e përgatit.

3. Njëkohësisht me kërkesën për çkarkimin nga shpenzimet dhe taksat gjyqësore mund të paraqitet me gojë edhe kërkesa për ngritjen e padisë ose të ndonjë procedimi tjetër, duke u shënuar kjo në proces verbalin.

#### Neni 23

Dërgimi i vërtetimeve mbi gjendjen civile dhe dokumentave të tjera

1. Secila Palë Kontraktonjëse, në bazë të kërkesave të bëra në rrugë diplomatike, i përcjell Palës tjetër Kontraktonjëse dëshmi mbi regjistrimin e akteve të gjendjes civile, dokumenta mbi arësimin, mbi vjetërsinë në punë dhe dokumenta të tjera që kanë lidhje me të drejtat personale dhe interesat e shtetasve të Palës tjetër Kontraktonjëse.

2. Dokumentat e përmendura në pikën 1 i dërgohen Palës tjetër Kontraktonjëse në rrugë diplomatike të papërkthyer dhe falas.

MPJ ARKIVI

VITI: 1960

FLETA: C4

Dispozita mbi statutin personal

Neni 24

Zotësia për të vepruar

Zotësia për të vepruar e një personi përcaktohet nga legjislacioni i Palës Kontraktgjëse shtetas i së cilës ai është.

Neni 25

Deklarimi i çdukjes ose i vdekjes dhe konstatimi i faktit të vdekjes

1. Për çështjet e deklarimit të çdukjes ose të vdekjes së një personi si dhe të konstatimit të faktit të vdekjes janë kompetente organet e palës Kontraktgjëse, shtetas i së cilës, sipas të dhënave të fundit, ka qënë personi kur ishte gjallë.

2. Organet e njerës Palë Kontraktgjëse mund ta deklarojnë shtetasin e Palës tjetër Kontraktgjëse si të çdukur ose si të vdekur dhe të konstatojnë faktin e vdekjes së tij:

a) kur kërkesa paraqitet nga personi që pretendon të drejta trashëgimie mbi pasurinë e luejtëshme dhe të paluejtëshme e cila gjendet në teritorin e saj;

b) kur kërkesa paraqitet nga bashkëshorti ose nga bashkëshortja, që në kohën e paraqitjes së kërkesës banon në teritorin e saj.

3. Në rastet që parashikohen nga pikat 1 e 2, deklarimi i personit si të zhdukur ose si të vdekur bëhet në përputhje me legjislacionin e shtetit, shtetas i të cilit ishte personi në kohën e zhdukjes së tij.

E drejta familjare

Neni 26

Kushtet për lidhjen e martesës

1. Kushtet që kërkohen për secilin bashkëshort të ardhëshëm për lidhjen e martesës, përcaktohen nga legjislacioni i Palës Kontraktgjëse shtetas i së cilës është ky bashkëshort i ardhëshëm.

2. Në kushtet që kërkohen për lidhjen e martesës hyn edhe autorizimi i organeve shtetërore kompetente, kur një autorizim i tillë parashikohet nga legjislacioni i Palës Kontraktgjëse shtetas i së cilës është bashkëshorti i ardhëshëm.

MPJ ARKIVI

VITI: 1960

DOSJA:

FLETA: CF

Neni 27

Forma e lidhjes së martesës

1. Forma e lidhjes së martesës përcaktohet nga legjislacioni i Palës Kontraktgjëse, në teritorin e së cilës bëhet lidhja e martesës.

2. Forma e lidhjes së martesës, që zbatohet nga përfaqësorët diplomatik ose konsullor i autorizuar, përcaktohet nga legjislacioni i vendit të përfaqësimit diplomatik ose konsullor.

Neni 28.

Marrëdhëniet juridike personale dhe pasurore të bashkëshortëve

1. Marrëdhëniet juridike personale dhe pasurore të bashkëshortëve, përcaktohen nga legjislacioni i asaj Pale Kontraktgjëse shtetase të së cilës janë bashkëshortët.

2. Kur njeri nga bashkëshortët është shtetas i njerës Pale Kontraktgjëse dhe tjetri është shtetas i Palës tjetër Kontraktgjëse, marrëdhëniet e tyre juridike personale dhe pasurore përcaktohen nga legjislacioni i asaj Pale Kontraktgjëse, në teritorin e së cilës ata kanë ose kanë patur kohët e fundit vendbanimin e përbashkët të tyre.

Neni 29

Zgjidhja e martesës dhe deklarimi i saj si e pavlefshme

1. Për çështjet e zgjidhjes së martesës dhe deklarimit të saj si të pavlefshëm zbatohet legjislacioni dhe parimisht kompetentë janë gjykatat e asaj Pale Kontraktgjëse, shtetas të së cilës kanë qënë bashkëshortët në kohën e ngritjes së padisë. Kur bashkëshortët kanë vendbanimin në teritorin e Palës tjetër Kontraktgjëse, janë kompetente gjithashtu edhe gjykatat e kësaj Pale Kontraktgjëse të cilat zbatojnë legjislacionin e Palës Kontraktgjëse shtetase të së cilës janë bashkëshortët.

2. Kur në kohën e ngritjes së padisë mbi zgjidhjen e martesës ose për deklarimin e saj si të pavlefshme njeri nga bashkëshortët është shtetas i njerës Pale Kontraktgjëse dhe tjetri shtetas i Palës tjetër Kontraktgjëse kompetente janë gjykatat e asaj Pale Kontraktgjëse

MPJ ARKIVI

VITI: 1960

DOSJA:

FLETA: 24/

në territorin e së cilës kanë vendbanimin e tyre, të cilat zbatojnë legjislacionin e vendit të tyre.

3. Kur në kohën e ngritjes së padisë mbi zgjidhjen e martesës ose për deklarimin e saj si të pavlefshme njeri nga bashkëshortët është shtetas i njerës Palë Kontraktgjëse dhe tjetri shtetas i Palës tjetër Kontraktgjëse dhe njeri banon në territorin e njerës dhe tjetri në territorin e tjetrës Palë Kontraktgjëse, kompetente janë gjykatat e të dy Palëve Kontraktgjëse të cilat zbatojnë legjislacionin e vendit të tyre.

Marrëdhëniet juridike midis prindërve dhe fëmijëve

Neni 30

Marrëdhëniet juridike midis prindërve dhe fëmijëve, duke përfshirë dhe çështjet mbi kundërshtimin dhe vërtetimin e atësisë ose amësisë, përcaktohen nga legjislacioni i Palës Kontraktgjëse shtetas i së cilës është fëmija.

Neni 31

1. Për dhënien e vendimeve në lidhje me marrëdhëniet juridike që përmenden në nenin 30 janë kompetente gjykatat e Palës Kontraktgjëse, shtetas i së cilës është fëmija.

2. Në qoftë se të dyja palët në konflikt banojnë në territorin e njerës Palë Kontraktgjëse, atëherë kompetente janë gjithashtu edhe gjykatat e kësaj Palë Kontraktgjëse.

A d o p t i m i

Neni 32

1. Në raste adoptimi zbatohet legjislacioni i asaj Palë Kontraktgjëse, shtetas i së cilës është adoptuesi.

2. Në qoftë se fëmija adoptohet nga bashkëshortët, njeri nga të cilët është shtetas i njerës dhe tjetri i tjetrës Palë Kontraktgjëse, adoptimi duhet të bëhet në përputhje me legjislacionin që është në fuqi në territorin e të dy Palëve Kontraktgjëse.

3. Në qoftë se fëmija është shtetas i njerës Palë Kontraktgjëse dhe adoptuesi është shtetas i Palës tjetër Kontraktgjëse, atëherë në adoptimin duhet të merret pëlqimi i fëmijës në qoftë se kjo kërkohet nga ligja e Palës Kontraktgjëse, shtetas i së cilës është fëmija, dhe të

NPJ ARKIVI

VITI: 1960

DOSJA:

FLETA: 14

përfaqësuesit ligjor të familjës ose të organit kompetent të kësaj Pale Kontraktonjëse.

Neni 33

Kompetente për çështjet e adoptimit janë organet e Palës Kontraktonjëse, shtetas i së cilës është adoptuesi. Në rastin e përmendur në pikën 2 neni 32 është kompetent organi i asaj Pale Kontraktonjëse në territorin e së cilës bashkëshortët kanë ose kanë patur në kohën e fundit vendbanimin ose vendqëndrimin e tyre të përbashkët.

Neni 34

Dispozitat e neneve 32 e 33 zbatohen respektivisht edhe për pushimin e adoptimit.

Kujdestaria dhe tutoria

Neni 35

1. Për çështjet e kujdestarisë dhe tutorisë ndaj shtetasve të Palëve Kontraktonjëse, kur kjo Konventë nuk parashikon ndryshe, zbatohet legjislacioni dhe janë kompetente organet e asaj Pale Kontraktonjëse shtetas i së cilës është personi i vënë nën kujdestari ose tutori.

2. Marrëdhëniet juridike midis kujdestarit ose tutorit dhe personit që gjendet nën kujdestari ose tutori përcaktohen nga legjislacioni i Palës Kontraktonjëse, organi i së cilës ka emëruar kujdestarin ose tutorin.

3. Për detyrimin e pranimit të kujdestarisë ose tutorisë vepron legjislacioni i Palës Kontraktonjëse, shtetas i së cilës është kujdestari ose tutori i ardhëshëm.

Neni 36.

1. Kur marrja e masave në lidhje me kujdestarinë ose tutorinë kërkohet për interesat e personit të vënë nën kujdestari ose tutori, vendbanimi, vendqëndrimi ose pasuria e të cilit ndodhet në territorin e Palës tjetër Kontraktonjëse, organi i kujdestarisë i kësaj Pale Kontraktonjëse e njofton me një herë mbi këtë organin kompetent të shtetit, shtetas i së cilës është ky person.

2. Në raste të ngutëshme, organi i palës tjetër Kontraktonjë-

NPJ ARKIVI

VITI: 1960

FLETA: C 47

se mund të marrë edhe vetë masa të përkohëshme në përputhje me kushtet (lokali, mbajtja, kujdesi), por ai duhet të njoftojë menjëherë për këtë organin kompetent të shtetit, shtetas i të cilit është ky person. Këto masa qëndrojnë në fuqi gjer sa organet e përmendura në pikën 1 të nenit 35 nuk do të marrin ndonjë vendim tjetër.

#### Neni 37

1. Organi shtetëror i shtetasit mund të kërkojë nga organi kompetent i Palës tjetër Kontraktgjëse që ai të pranojë të ushtrojë kujdestarinë ose tutorinë kundrejt personit, vendbanimi, vendqëndrimi i përhershëm ose pasuria e të cilit ndodhet në teritorin e Palës tjetër Kontraktgjëse. Kalimi i kujdestarisë ose tutorisë hyn në fuqi, kur organi, të cilit i është drejtuar kërkesa, do të pranojë ushtrimin e kujdestarisë ose tutorisë dhe do të njoftojë për këtë organin që ka bërë kërkesën.

2. Organi, i cili ka pranuar të ushtrojë kujdestarinë ose tutorinë sipas pikës 1, e ushtron këtë në përputhje me legjislacionin e shtetit të tij. Por ai duhet të zbatojë legjislacionin e Palës Kontraktgjëse, shtetasi i së cilës është personi nën kujdestari ose personi nën tutori, për sa i përket zotësisë juridike ose zotësisë për të vepruar të personit që është nën kujdestari ose tutori. Ai nuk ka të drejtë të japë vendime për çështjet që i përkasin statutit personal të personit nën kujdestari ose tutori, por mund të japë leje për martesë, kur kjo është e nevojshme sipas ligjës së Palës Kontraktgjëse, shtetas i së cilës është personi i vënë nën kujdestari ose tutori.

#### E drejta e trashëgimisë

#### Neni 38

#### Parimi i barazisë

Shtetasit e njerës Palë Kontraktgjëse gëzojnë në teritorin e Palës tjetër Kontraktgjëse të drejta të barabarta me shtetasit e Palës tjetër Kontraktgjëse për të trashëguar me ligjë ose me testament pasurinë që ndodhet në teritorin e kësaj Pale Kontraktgjëse, si edhe për të bërë dhe për të revokuar testamentin.

NPJ ARKIVI  
VITI: 1960  
DOSJA:

FLETA: C 4/

Neni 39

Mbi legjislacionin që zbatohet

1. E drejta e trashëgimisë mbi një pasuri të luejtëshme rregullohet nga legjislacioni i asaj Palë Kontraktgjëse, shtetas i së cilës ka qënë trashëgimlënësi në çastin e vdekjes së tij.

2. E drejta e trashëgimisë mbi një pasuri të paluejtëshme rregullohet nga legjislacioni i asaj Palë Kontraktgjëse në teritorin e së cilës ndodhet pasuria.

Neni 40

Testamenti

1. Forma e testamentit përcaktohet nga legjislacioni i Palës Kontraktgjëse, shtetas i së cilës ka qënë trashëgimlënësi në kohën që është bërë testamenti. Me gjithë atë, mjafton edhe të jetë respektuar legjislacioni i Palës Kontraktgjëse, në teritorin e së cilës është bërë testamenti. Këto dispozita vlejné edhe për revokimin e testamentit.

2. Zotësia për të bërë ose revokuar testament si dhe pasojat juridike të të metave në çfaqjen e vullnetit përcaktohen nga legjislacioni i Palës Kontraktgjëse, shtetas i së cilës ka qënë trashëgimlënësi në kohën e çfaqjes së vullnetit. Po nga ky legjislacion përcaktohen edhe llojet e testamentave që lejohen.

Neni 41

Kompetenca në çështjet e trashëgimit

1. Çështjet në lidhje me trashëgimin e pasurisë së luejtëshme, me përjashtim të rastit që parashikohet në pikën 4 të këtij neni, shqyrtohen nga organet kompetente të Palës Kontraktgjëse shtetas i së cilës ka qënë trashëgimlënësi në çastin e vdekjes.

2. Çështjet në lidhje me trashëgimin e pasurisë së paluejtëshme shqyrtohen nga organet kompetente të Palës Kontraktgjëse, në teritorin e së cilës ndodhet kjo pasuri.

3. Dispozitat e pikave 1 dhe 2 të këtij neni zbatohen, respektivisht, edhe në konfliktet që lindin në bazë të të drejtave trashëgimore.

4. Nëqoftëse e gjithë pasuria e luejtëshme trashëgimore, që

MPJ ARKIVI

VITI: 1960

NR:

FLETA: C 4

ka mbetur pas vdekjes së shtetasit të një Pale Kontraktonjëse, ndodhet në teritorin e Palës tjetër Kontraktonjëse, dhe në qoftëse janë të një mendimi të gjithë trashëgimtarët, atëherë me kërkesën e trashëgimtarit ose të personit në dobi të të cilit është lënë legu, procedimi për çështjen në lidhje me trashëgimin bëhet në organet kompetente të kësaj Pale Kontraktonjëse.

#### Neni 42

##### Njoftimi për vdekjen

1. Kur shtetasi i njerës Palë Kontraktonjëse vdes në teritorin e Palës tjetër Kontraktonjëse, organi përkatës duhet të lajmërojë me njëherë për vdekjen përfaqësinë diplomatike ose konsullore të vendit, shtetas i së cilës ka qënë i vdekuri, dhe t'i njoftojë gjithëçka që di për trashëgimtarët, ose për personin në dobi të të cilit është lënë legu, për vendbanimin ose vendqëndrimin ose adresën e tyre, për gjendjen e trashëgimit si edhe për faktin në se ka testament. Organi i lartpërmendur dërgon një njoftim të tillë edhe kur i vdekuri ka lënë pasuri në teritorin e një shteti të tretë, në qoftë se ai ka dijeni për këtë gjë.

2. Në qoftë se trashëgimi çelet në teritorin e njerës Palë Kontraktonjëse dhe merret vesh se trashëgimtari ose personi në favorin e të cilit është lënë legu, është shtetas i Palës tjetër Kontraktonjëse, për këtë gjë organi lokal përkatës njofton me njëherë përfaqësinë diplomatike ose konsullore të Palës tjetër Kontraktonjëse.

#### Neni 43

##### Të drejtat e përfaqësive diplomatike ose konsullore

1. Për të gjitha çështjet në lidhje me trashëgimin që lindin në teritorin e njerës nga Palët Kontraktonjëse, përfaqësia diplomatike ose konsullore ka të drejtë të përfaqësojë para organeve të Palës tjetër Kontraktonjëse interesat e shtetasve të shtetit të saj kur ata mungojnë ose nuk kanë caktuar përfaqësues të tyre; në këto raste nuk kërkohet ndonjë prokurë e veçantë.

2. Kur shtetasi i njerës Palë Kontraktonjëse, që banon përkohësisht në teritorin e Palës tjetër Kontraktonjëse, vdes, sendet që ai

MPJ ARKIVI

VITI: 1960

DOSSJA:

FLETA: 18



rishte me vehte i dorëzohen përfaqësisë diplomatike ose konsullore pa ndonjë formalitet.

Neni 44

Çelja e testamentit

1. Testamenti çelet nga organet kompetente të Palës Kontraktgjëse, në territorin e së cilës ndodhet testamenti. Kopja e testamentit dhe kopja e proces verbalit të çeljes së testamentit dhe në rast nevojë edhe origjinali i testamentit i dërgohen organit kompetent të Palës Kontraktgjëse, shtetas i së cilës ka qënë trashëgimlënësi.

2. Dispozitat e pikës 1 zbatohen respektivisht edhe për proces verbalin që mbahet gjatë pyetjeve të dëshmitarëve të testamentit verbal.

Neni 45

Masat për ruajtjen e trashëgimit

1. Organi i Palës Kontraktgjëse, në territorin e së cilës ndodhet trashëgimi i shtetasit të Palës tjetër Kontraktgjëse, është i detyruar që në përputhje me legjislacionin e tij të marrë masat e nevojëshme për ruajtjen dhe administrimin e pasurisë trashëgimore.

2. Për masat e marra sipas pikës 1 duhet të njoftohet me një herë përfaqësia diplomatike ose konsullore e Palës tjetër Kontraktgjëse, e cila mund të marrë pjesë vetë ose me anë të përfaqësuesit të saj në zbatimin e këtyre masave. Me kërkesën e përfaqësisë këto masa mund të ndryshohen ose të revokohen.

Neni 46

Dorëzimi i trashëgimit

1. Kur pasuria e luejtëshme trashëgimore ose shuma e nxjerrë nga shitja e pasurisë së luejtëshme ose të paluejtëshme trashëgimore pas përfundimit të procedimit trashëgimor, duhet t'u dorëzohet trashëgimtarëve, që ndodhen në territorin e Palës tjetër Kontraktgjëse, pasuria e luejtëshme ose shuma e nxjerrë i dorëzohen përfaqësisë diplomatike ose konsullore të këtij shteti.

2. Organi, që merret me çështjet e trashëgimisë, urdhëron dorëzimin e trashëgimit përfaqësisë diplomatike ose konsullore në këto raste:

a) kur të gjitha kërkesat e kreditorëve të të vdekurit, të pa-

MPJ ARKIVI

VITI: 1960

DOSJA:

FLETA: 09/

raçitura mbrenda afateve të caktuara nga legjislacioni i Palës Kontrakt-  
njëse, janë paguar ose siguruar;

b) kur të gjitha taksat që rjedhin nga trashëgimi janë paguar  
ose janë siguruar;

c) kur organet kompetente kanë dhënë leje për nxjerrjen jashtë  
shtetit të pasurisë trashëgimore ose të shumave të nxjerra nga shitja e  
saj, në rast se një leje e tillë kërkohet.

#### Njohja dhe ekzekutimi i vendimeve

##### Neni 47

1. Vendimet e gjykatave dhe organeve të tutorisë dhe kujdesta-  
risë të njerës Palë Kontraktgjëse në lidhje me çështjet me karakter jo  
pasuror që kanë marrë formën e prerë dhe nuk janë në kundërshtim me këtë  
Konventë, njihen në teritorin e Palës tjetër Kontraktgjëse pa një procedim  
të mëtejshëm, kur asnjë gjykatë ose organ i tutorisë dhe kujdestarisë  
të Palës tjetër Kontraktgjëse nuk ka dhënë më parë ndonjë vendim për kë-  
të çështje, i cili të ketë marrë formë të prerë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe për vendimet e dhëna para hyr-  
jes në fuqi të kësaj Konvente.

2. Vendimet e gjykatave në çështjet civile dhe familjare me  
karakter pasuror të dhëna në teritorin e njerës Palë Kontraktgjëse dhe  
që kanë marrë formë të prerë, njihen dhe ekzekutohen në teritorin e Palës  
tjetër Kontraktgjëse kur këto vendime janë dhënë pas hyrjes në fuqi të  
kësaj Konvente.

Kjo dispozitë zbatohet edhe për vendimet e dhëna nga gjyka-  
tat që kanë marrë formë të prerë dhe që kanë të bëjnë me shpërblimin e dë-  
mit që rjedh nga çështjet penale.

##### Neni 48

1. Shqyrtimi i kërkesave për lejimin e ekzekutimit të detyrue-  
shëm hyn në kompetencën e gjykatave të Palës Kontraktgjëse në teritorin  
e së cilës duhet të bëhet ekzekutimi i detyrueshëm.

2. Kërkesa për ekzekutimin e detyrueshëm i paraqitet gjykatës  
që ka dhënë vendimin mbi çështjen në shkallë të parë ose gjykatës kompe-

RPJ ARKIVI

VITI: 1960

DOSJA:

FLETA: 14/

tente të Palës tjetër Kontraktgjëse. Gjykata e shkallës së parë i dërgon kërkesën e marrë gjykatës kompetente të Palës tjetër Kontraktgjëse.

Neni 49

Kërkesës për lejimin e ekzekutimit të detyrueshëm i bashkëngjiten:

- a) teksti i plotë i vendimit sidhe vërtetimi zyrtar se vendimi ka marrë formën e prerë, në qoftë se kjo nuk del nga teksti i vetë vendimit;
- b) dokumenti nga i cili del se të paditurit që nuk mori pjesë në gjykimin ose përfaqësuesit të tij i është dërguar në kohën dhe në formën e duhur dhe të paktën një herë lajmërimi për tu paraqitur në gjykatë;
- c) përkthimi i vërtetuar i kërkesës dhe dokumentave që përmenden në pikat a dhe b.

Neni 50

Gjatë shqyrtimit të kërkesës për lejimin e ekzekutimit të detyrueshëm, gjykata mund të thërrisë në rast nevojë personin që ka paraqitur kërkesën, t'i kërkojë sqarime ose ta detyrojë atë të plotësojë të metat që mund të ketë kërkesa. Ajo mund të marrë gjithashtu në pyetje debitorin rreth thelbit të kërkesës dhe të kërkojë sqarime nga gjykata që ka dhënë vendimin.

Neni 51

1. Procedimi i ekzekutimit të detyrueshëm rregullohet nga Legjislacioni i Palës Kontraktgjëse në teritorin e së cilës duhet të bëhet ekzekutimi i detyrueshëm.

2. Debitori mund të kundërshtojë para gjykatës, që ka dhënë vendim për ekzekutimin e detyrueshëm, si për lejimin e ekzekutimit të detyrueshëm, ashtu edhe për kërkesat e pranuar me vendimin e gjykatës, vetëm në rast se një gjë e tillë lejohet nga legjislacioni i Palës Kontraktgjëse, në teritorin e së cilës është dhënë vendimi.

Neni 52

Refuzimi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore

Lejimi i ekzekutimit të detyrueshëm të vendimeve gjyqësore

MPJ ARKIVI

VITI: 1960

KASJA:

FLETA: 14/

re mund të refuzohet:

a) kur vendimi, ekzekutimi i të cilit kërkohet, nuk ka marrë formë të prerë;

b) kur i padituri ose personi në çështje kundër të cilit është dhënë vendimi, nuk ka marrë pjesë në gjykimin për shkak se atij ose përfaqësuesit të tij nuk i qe bërë me kohë dhe në formën e duhur thirrja për në gjykatë, sipas procedurës së parashikuar nga kjo Konventë;

c) kur vendimi gjyqësor është në kundërshtim me një vendim të mëparshëm, që ka marrë formë të prerë, të dhënë për një çështje midis po atyre palëve, po për atë shkak dhe po për ato objekte nga gjykata e Palës Kontraktgjyqësore, në teritorin e së cilës duhet të njihet vendimi ose të kryhet ekzekutimi i detyrueshëm. Kjo dispozitë, nuk shtrihet në ato raste kur kanë ndryshuar në mënyrë thelbësore rrethanat, në bazë të të cilave janë përcaktuar, nga vendimi gjyqësor i mëparshëm, përmbajtja dhe koha e ekzekutimit.

#### Neni 53

Për shpenzimet gjyqësore, që kanë të bëjnë me ekzekutimin e detyrueshëm, zbatohet legjislacioni i Palës Kontraktgjyqësore në teritorin e së cilës duhet të ekzekutohet vendimi.

#### Neni 54

Dispozitat e neneve 47-53 të kësaj Konvente zbatohen edhe për marrëveshjet e pajtimit të përfunduara para gjykatave.

### KAPITULLI II

#### NDIHMA JURIDIKE PËR ÇËSHTIET PENALE

#### Neni 55

##### Dorëzimi i detyrueshëm

1. Palët Kontraktgjyqësore, në përputhje me kushtet e kësaj Konvente, në bazë të kërkesës detyrohen t'i dorëzojnë njera tjetrës personat që ndodhen në teritorin e tyre, për ndjekje penale ose për ekzekutimin e vendimit.

2. Dorëzimi lejohet vetëm për ato vepra, të cilat, në përputhje me legjislacionin e të dy Palëve Kontraktgjyqësore, njihen si krime dhe dënohen me heqje të lirisë për më shumë se një vit ose me një dënim më të

ARXIVI

NUMERI: 1960

ORGANI:

FLETA: 24/

rëndë (që më tutje do të quhen "krime që sjellin me vehte dorëzimin").

#### Neni 56

##### Refuzimi i dorëzimit

Dorëzimi nuk mund të bëhet:

- a) kur personi, dorëzimi i të cilit kërkohet, është shtetas i Palës Kontraktgjëse, së cilës i është drejtuar kërkesa;
- b) kur personi, dorëzimi i të cilit kërkohet, ka kryer krimin në territorin e Palës Kontraktgjëse, së cilës i është drejtuar kërkesa për dorëzim;
- c) kur ndjekja penale ose ekzekutimi i vendimit, në bazë të legjislacionit të Palës Kontraktgjëse, së cilës i është drejtuar kërkesa, nuk lejohet për arsye të kalimit të afatit të parashkrimit ose për arsye të dispozitave të tjera ligjore;
- ç) kur kundërt personit, dorëzimi i të cilit kërkohet, gjykata e Palës Kontraktgjëse, së cilës i është drejtuar kërkesa, po për të njëjtin krim ka dhënë vendim që ka marrë formë të prerë ose jo të prerë ose një vendim për pushimin e procedimit të çështjes.

#### Neni 57

##### Detyrimi për të filluar ndjekje penale

1. Secila Palë Kontraktgjëse, me kërkesën e Palës tjetër Kontraktgjëse, detyrohet të fillojë, në përputhje me legjislacionin e saj, ndjekje penale kundra shtetasve të saj, të cilët kanë kryer në territorin e Palës tjetër Kontraktgjëse një krim që sjell me vehte dorëzimin.

Kërkesës i bashkëngjiten dokumentat që përmbajnë të dhëna në lidhje me krimin si edhe të gjitha provat që disponohen për vërtetimin e krimit.

2. Kërkesat për fillimin e ndjekjes penale, gjer në fazën e dërgimit në gjykatë, paraqiten nga Prokuroritë e Përgjithëshme, ndërsa mbas dërgimit në gjykatë nga Ministrinë e Drejtësisë së Palëve Kontraktgjëse.

3. Pala Kontraktgjëse, së cilës i është drejtuar një kërkesë e tillë, njofton Palën tjetër Kontraktgjëse për rezultatet e gjyqimit penal dhe, në rast se është dhënë vendimi i formës së prerë, i dërgon

KPJ ARKIVI

VITI: 1960

DOSJA:

FLETA 14 /

kopjen e vendimit.

Neni 58

Mënyra e komunikimit për çështjet e dorëzimit

Për çështjet e dorëzimit Ministrinë e Drejtësisë të Palëve Kontraktgjëse, meren vesh direkt njëra me tjetrën.

Neni 59

Kërkesa për dorëzim

1. Kërkesës për dorëzim me qëllim ekzekutimi të vendimit i bashkangjiten kopja e vërtetuar e vendimit që ka marrë formën e prerë si edhe teksti i plotë i ligjës në bazë të të cilës cilësohet krimi.

Në qoftë se i dënuari ka vuajtur një pjesë të dënimit, njoftohen edhe për këtë të dhënat përkatëse.

2. Kërkesës për dorëzim me qëllim ndjekjeje penale duhet t'i bashkangjitet kopja e vërtetuar e vendimit për arrestim, përshkrimi i rethanave të krimit si dhe teksti i ligjës, në bazë të së cilës cilësohet krimi; në qoftë se nga krimi është shkaktuar një dëm material, atëhere duhet shënuar edhe përpjestimi i dëmit.

3. Kërkesës për dorëzim mundësisht i bashkangjitet përshkrimi i karakteristikave të jashtme të personit, të dhënat mbi identitetin e tij, shtetësinë, vendbanimin e tij, si dhe fotografitë dhe shenjat e gishtave të tij.

4. Pala Kontraktgjëse që paraqet kërkesën nuk është e detyruar t'i bashkangjitet kërkesës provat e fajsisë së personit, dorëzimi i të cilit kërkohet.

Neni 60

Informata plotësuese për kërkesën për dorëzim

Në qoftë se në kërkesën për dorëzim nuk shënohen të gjitha të dhënat e nevojshme, Pala Kontraktgjëse, së cilës i është drejtuar kërkesa, mund të kërkojë informata plotësuese. Për këtë, ajo mund t'i caktojë Palës Kontraktgjëse, që ka paraqitur kërkesën, një afat të caktuar, i cili nuk mund të kalojë dy muaj. Për arsye të justifikuara ky afat mund të zgjatet.

Neni 61

Arestimi i personit që duhet të dorëzohet

Me marrjen e kërkesës për dorëzim, Pala Kontraktgjëse,

NPJ ARKIVI

VITI: 1960

DOSJA:

FLETA: 24/

së cilës i është drejtuar kërkesa, duhet të marrë me një herë masat për arrestimin e personit që kërkohet për dorëzim, me përjashtim të rasteve, kur në bazë të kësaj Konvente dorëzimi nuk mund të bëhet.

#### Neni 62

Mbajtja në gjendje arrestimi para marrjes së kërkesës  
për dorëzim

1. Personi që duhet të dorëzohet mund të arrestohet edhe para marrjes së kërkesës për dorëzim, kur arrestimi i tij kërkohet nga njera nga Palët Kontraktgjëse për shkak se ka vendim për arrestimin e këtij personi, ose vendim që ka marrë formë të prerë ose ndonjë vendim tjetër përkatës të gjykatës.

Kërkesa për arrestim mund të bëhet me anë të postës, telegrafit, telefonit ose të radios.

2. Organet përkatëse të Palëve Kontraktgjëse mund të arrestojnë personin që gjendet në territorin e tyre edhe pa marrë një kërkesë të tillë, kur ky person sipas njoftimeve të tyre ka kryer në territorin e Palës tjetër Kontraktgjëse një krim që shkakton dorëzimin.

3. Për kohën e arrestimit që parashikohet në pikat 1 dhe 2 duhet të njoftohet menjëherë Pala tjetër Kontraktgjëse.

#### Neni 63

Lirimi i personit të arrestuar

1. Personi i arrestuar mund të lirohet në qoftë se, në përputhje me nenin 60, Pala Kontraktgjëse që paraqiti kërkesën për dorëzim, nuk do të dërgojë informatat plotësuese në lidhje me kërkesën për dorëzim, mbrenda afatit të caktuar sipas atij neni.

2. Personi i arrestuar në bazë të nenit 62 mund të lirohet në qoftë se gjatë dy muajve nga dita e nisjes së njoftimit për arrestim Pala tjetër Kontraktgjëse nuk do të paraqesë kërkesën për dorëzim.

#### Neni 64

Shtytja e dorëzimit

Kur personi, dorëzimi i të cilit kërkohet, është marrë në përgjegjësi penale, ose është dënuar për një krim tjetër në territorin e Palës Kontraktgjëse, së cilës i është drejtuar kërkesa, dorëzimi mund të

NPJ ARKIVI

VITI: 1960

DOSJA:

FLETA: 66

shtyhet gjer në pushimin e gështjes penale ose gjersa të vihet në ekzekutim vendimi, ose gjersa të lirohet nga vuajtja e dënimit.

Neni 65

Dorëzimi i përkohëshëm

1. Në qoftëse shtytja e dorëzimit, që parashikohet nga neni 64, mund të shkaktojë kalimin e afatit të parashkrimit për ndjekjen penale, ose një dëm të madh hetimit të gështjes penale, atëhere në bazë të kërkesës përkatëse personi i kërkuar mund të dorëzohet përkohësisht.

2. Personi i dorëzuar përkohësisht duhet të kthehet pas përfundimit të procedimit penal në lidhje me gështjen për të cilën ai ishte dorëzuar.

Neni 66

Paraqitja e shumë kërkesave për dorëzim

Kur kërkesat për dorëzim bëhen nga disa shtete, Pala Kontraktgjëse, së cilës i drejtohen kërkesat, vendos secila nga këto kërkesa duhet të pranohet.

Neni 67

Kufitë e ndjekjes kundër personit të dorëzuar

1. Pa pëlqimin e Palës Kontraktgjëse, së cilës i është drejtuar kërkesa, personi i dorëzuar nuk mund të merret në përgjegjësi penale, të dënohet ose t'i dorëzohet një shteti të tretë për një krim të kryer para dorëzimit, për të cilin ai nuk u dorëzua.

Nuk mund të refuzohet pëlqimi për marrjen në përgjegjësi penale të një personi, në qoftë se ky ka kryer krimin në territorin e Palës, që ka paraqitur kërkesën, krim që në bazë të kësaj Konvente sjell me vehte dorëzimin.

2. Pëlqimi nuk kërkohet:

a) kur personi i dorëzuar nuk u largua nga territori i Palës Kontraktgjëse, së cilës i është dorëzuar, mbrenda një muaji nga çasti i përfundimit të procedimit të gështjes, dhe, në rast dënimi, nga dita e marrimit të vuajtjes së dënimit, ose nga dita e lirimit nga dënimi. Në këtë afat nuk llogaritet koha gjatë së cilës personi i dorëzuar nuk ka mundur të largohet, jo për faj të tij, nga territori i Palës Kontraktgjëse, e cila ka paraqitur kërkesën;

RPJ ARKIVI

VITI: 1960

POSJA:

FLETA: 14/



b) kur personi i dorëzuar u largua nga territori i Palës Kontraktgjëse, që ka paraqitur kërkesën, dhe pastaj u kthye rishtaz.

Neni 68

Dorëzimi

Para Kontraktgjëse, së cilës i është drejtuar kërkesa, njofton Palën Kontraktgjëse që ka paraqitur kërkesën për kohën dhe vendin e dorëzimit.

Në qoftëse Para Kontraktgjëse që ka paraqitur kërkesën, nuk e merr në dorëzim personin që është kërkuar për dorëzim, mbrenda 15 ditëve pas datës së caktuar për dorëzim; ky person mund të lirohet nga arrestimi.

Neni 69

Dorëzimi rishtaz

Në qoftë se personi i dorëzuar i shmangët në çdo farë mënyre ndjekjes penale dhe kthehet rishtaz në territorin e Palës Kontraktgjëse nga e cila u kërkuar dorëzimi i tij, atëherë me një kërkesë të re ai duhet të dorëzohet pa u paraqitur dokumentat që përmenden në nenin 59.

Neni 70

Kalimi tranzit

1. Secila Palë Kontraktgjëse detyrohet me kërkesën e Palës tjetër Kontraktgjëse të lejojë kalimin në territorin e saj të personave që i dorëzohen Palës tjetër Kontraktgjëse nga një shtet i tretë.

Palët Kontraktgjëse nuk janë të detyruar të lejojnë një kalim të tillë, në qoftë se dispozitat e kësaj Konvente nuk parashikojnë dorëzimin.

2. Kërkesa për kalimin tranzit duhet të përpilohet dhe të paraqitet në të njëjtën mënyrë si dhe kërkesa për dorëzim.

3. Kalimi tranzit bëhet nga organet e Palës Kontraktgjëse, së cilës i është paraqitur kërkesa, në mënyrat më të përshtatëshme për ato.

Neni 71

Njoftimi i përfundimit të ndjekjes penale

Palët Kontraktgjëse i njoftojnë njera tjetrës për-

MPJ ARKIVI

VITI: 1960

NO.:

FLETA: C4

fundimin e ndjekjes penale kundër personit të dorëzuar prej tyre.

Në qoftë se personi i dorëzuar u dënua, pasi vendimi të ketë marrë formë të prerë dërgohet kopja e tij.

#### Neni 72

Dorëzimi i personave që mbahen të arrestuar

1. Kur personi që është thirur si dëshmitar ndodhet i arrestuar në teritorin e Palës tjetër Kontraktgjyqësore, por akoma nuk i është dërguar gjykatës, për sjelljen e tij në teritorin e Palës Kontraktgjyqësore, që ka paraqitur kërkesën, mund të urdhërojë Prokuroria e Përgjithëshme e Palës Kontraktgjyqësore, së cilës i është drejtuar kërkesa. Kur personi i përmendur i është dërguar gjykatës, për sjelljen e tij mund të urdhërojë Ministria e Drejtësisë së Palës Kontraktgjyqësore, së cilës i është drejtuar kërkesa. Personi i dërguar duhet të mbahet i arrestuar dhe duhet të kthehet mbrenda një kohe sa më të shkurtër mbas marrjes së tij në pyetje.

2. Në qoftë se organi i Palës Kontraktgjyqësore, që ka paraqitur kërkesën ka nevojë të marrë në pyetje si dëshmitar personin, i cili mbahet i arrestuar në një shtet të tretë, kalimi tranzit i këtij personi nëpërmjet të teritorit të shtetit të tij bëhet me lejen e Ministrisë së Drejtësisë të Palës Kontraktgjyqësore, së cilës i është drejtuar kërkesa. Në këtë rast respektohen dispozitat e nenit 7 të kësaj Konvente.

#### Neni 73

Dorëzimi i sendeve

1. Sendet që i u gjetën personave si rezultat i kryerjes së krimit që sjell me vete dorëzimin, ose vlefte e tyre, si dhe të gjitha sendet e tjera, të cilat mund të vlejné për çështjen penale si prova materiale, duhet t'i dorëzohen Palës Kontraktgjyqësore, e cila ka paraqitur kërkesën, edhe në ato raste, kur dorëzimi i personit që ka kryer krimin, nuk mund të bëhet për shkak të vdekjes së tij ose për shkaqe të tjera.

2. Pala Kontraktgjyqësore nga e cila kërkohet dorëzimi i sendeve, mund ta shtyjë përkohësisht dorëzimin e tyre në qoftë se ato i nevojiten për një çështje tjetër penale.

3. Të drejtat e personave të tretë mbi sendet që duhet të dorëzohen mbeten të paprekura. Mbas përfundimit të çështjes këto sende du-

NPJ ARKIVI

VITI: 1960

DOSJA:

LISTA: 24/

het t'i kthehen Palës Kontraktgjëse që i ka dorëzuar, për t'iu dorëzuar personave që kanë të drejtë mbi to.

Neni 74

Refuzimi i ndihmës juridike për çështje penale  
Ndhma juridike nuk jepet në qoftë se ajo kërkohet për krime që nuk sjellin me vete dorëzimin.

Neni 75

Njoftimi mbi dënimet penale

1. Palët Kontraktgjëse informojnë njera tjetrën për vendimet penale që kanë marrë formë të prerë, të dhëna nga gjykatat e tyre kundër shtetasve të Palës tjetër Kontraktgjëse. Këto njoftime jepen nga organet qendrore të Palëve Kontraktgjëse, të cilat mbajnë evidencat e çështjeve penale, duke shkëmbyer midis tyre listat e regjistrimeve.

2. Me kërkesën e organeve gjyqësore dhe të prokurorisë të njerës Palë Kontraktgjëse, organi qendror i Palës tjetër Kontraktgjëse, që mban evidencat e regjistrimit të çështjeve penale, u dërgon falas informatat përkatëse nga regjistrimet e tij.

3. Për rastet e parashikuara nga pikat 1 e 2, organet qendrore të Palëve Kontraktgjëse që mbajnë evidencat e regjistrimeve të çështjeve penale, do të dërgojnë njeri tjetrit, sipas mundësive, gjithashtu shenjat e gishtave të të dënuarve.

PJESA E III-të

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 76

Kjo Konventë duhet të ratifikohet. Shkëmbimi i instrumentave të ratifikimit do të bëhet në Budapest.

Neni 77

1. Kjo Konventë hyn në fuqi 30 ditë mbas shkëmbimit të instrumentave të ratifikimit. Konventa do të jetë në fuqi për 5 vjet nga dita e hyrjes së saj në fuqi.

2. Në qoftë se as njera nga Palët Kontraktgjëse nuk do të

RPJ ARKIVI

VITI 1960

FLETA: 24/

denoncojë këtë Konventë të paktën 6 muaj para mbarimit të afatit të lartpërmendur, fuqia e saj zgjatet për një kohë të pacaktuar gjersa njera nga Palët Kontraktgjese nuk do ta denoncojë atë me një paralajmërim prej një viti.

Neni 78

Kjo Konventë u përpilua në dy kopje, secila në gjuhën shqipe dhe hungareze dhe të dy tekstet kanë fuqi të barabartë.

Për vërtetim sa më sipër të Plotfuqishmit e të dy Palëve Kontraktgjese e nënshkruan këtë Konventë dhe e vulosën me vulat e tyre.

Bërë në Tiranë më 12 Janar 1960.

ME AUTORIZIM TË PRESIDIUMIT TË  
KUVENDIT POPULLOR TË REPUBLIKËS  
POPULLORE TË SHQIPËRISË

Bilbil Klosi

*Bilbil Klosi*

ME AUTORIZIM TË PRESIDIUMIT  
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË  
HUNGARISË

Dr. Ferenc Nezeval

*Dr. Ferenc Nezeval*

HPJ ARKIVI

VITI:

1960

NUMERI:

FLETA: C4/